



Mësime të mësuara për efektivitetin e administratës  
publike në Maqedoni

Analitika  
-Dhjetor 2008-  
[www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)

# Përmbledhje

Raporti “Mësime të mësuara për efektivitetin e administratës publike në Maqedoni” paraqet vazhdimësi të serisë së raporteve që programi i Administratës publike pranë qendrës për hulumtime Analitika publikon me qëllim që të ndikojë në zgjidhjen e problemeve që e tangojnë administratën publike. Qëllimi i këtij raporti qëndron në ofrimin e rekomandimeve të cilat do të çonin drejt efektivitetit të administratës publike në Maqedoni. Hulumtimet për këtë raport përfshijnë shfletim të raporteve esenciale që merren me inefektivitetin e administratës publike, intervista me ekspertë të ndryshëm si dhe me persona tjerë kyç. Këto metoda të lartpërmendura janë pjesë e metodologjisë së përdorur gjatë hartimit të këtij raporti.

Analiza e thellë e situatës aktuale në këtë fushë mundësoi që të krijohet një pasqyrë e qartë rreth asaj se çfarë është arritur deri tash; si dhe çfarë hapash tjerë duhet të ndërmerren që të përmirësohen performancat e sistemit të administratës publike në tërësi.

Rezultatet e këtij raporti siç janë: motivimi i punonjësve, strukturë më e mirë për menaxhim dhe vlerësim të performancës, teknologjia e informimit dhe komunikimit, implementimi i elementeve të sistemit të karrierës si kundërsulm ndaj politizimit të administratës publike, kontinuiteti i reformave në gjyqësor, lufta efektive ndaj korrupsionit si dhe përfaqësimi i barabartë për një administratë publike participative paraqesin elementet thelbësore të këtij raporti. Më poshtë vijojnë analizë përmbledhëse për secilin element të sipërpërmendur. Sidoqoftë, analiza më e zgjeruar mund të gjendet në raportin në fjalë.

**Motivimi i nëpunësve:** Përprjekjet për motivimin e punonjësve në Maqedoni duhet të vazhdojnë më intenzivisht. Rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet implementimit të drejtë të dispozitave të Ligjit për nëpunësit shtetëror.

**Strukturë më e mirë për menaxhim dhe vlerësim të performancës:** Menaxhimi dhe vlerësimi i performancës në sistemin e administratës publike të Maqedonisë është ende në gjendje fillestare. Kjo si pasojë e asaj se të kuptuarit e rëndësisë së menaxhimit dhe vlerësimit të performancës është i pamjaftueshëm ndërsa kapacitetet e organeve të administratës për implementimin e tyre janë të dobëta. Një proces më efikas i menaxhimit të performancës është më se i nevojshëm. Ndryshimet strukturale dhe koordinimi i rezultateve të nxjerra nga vlerësimi paraqiten si kryesiale për këtë proces.

**Teknologjia e informimit dhe komunikimit:** Është më se e qartë se Maqedonia duhet të ecë një rrugë të gjatë me qëllim që të instalojë infrastrukturë efikase për informim dhe komunikim. Hapa të ndryshëm janë ndërmarrë me qëllim të përafrimit me standardet e UE-së të vendosur për këtë fushë, ndër të cilët më i rëndësishëm duket të jetë ngritja e vetëdijes së institucioneve për rëndësinë e teknologjisë së informimit dhe komunikimit në efektivitetin e punës së tyre. Progres i mëtutjeshëm duhet të arrihet në trajnimin e punonjësve për përdorimin e teknologjive të informimit dhe komunikimit si dhe ofrimi i një game të gjerë shërbimesh dhe lehtësirash online.

**Implementimi i elementeve të sistemit të karrierës si kundërsulm ndaj politizimit të administratës publike:** Implementimi i një sistemi të kombinuar me elemente të sistemit

të karrierës dhe atij të vendeve të punës në Maqedoni do të paraqiste një përparim dhe përmirësim si të administratës shtetërore poashtu edhe të administratës publike në tërësi. Një gjë që paraqitet si esenciale për Maqedoninë është të forcojë dispozitat dhe implementimin e Ligjit për nëpunës shtetëror si dhe të rivendos rregulla të reja për sistemin në fjalë.

**Kontinuiteti i reformave në gjyqësor:** Maqedonia duhet të vazhdojë me reformat e filluara na gjyqësor. Përforcimi i kapaciteteve (njerzore dhe infrastrukturore) te Gjykatës administrative të sapohapur dhe sigurimi i konsensusit të gjerë politik-si një kriter i përgjithshëm, duhet të jenë prioritete kyçe drejt efektivitetit të sistemit gjyqësor.

**Lufta efektive kundër korrupsionit:** Maqedonia kryesisht duhet të përqëndrohet në depolitizimin e organeve anti-korrupsion si dhe në përforcimin e implementimit të Kodit etik për nëpunësit shtetëror dhe Ligjit për parandalimin e korrupsionit- që konsiderohen si korniza ligjore solide që përfshijnë gati se të gjitha parametrat për luftë efektive kundër korrupsionit.

**Përfaqësimi i barabartë për një administratë publike participative:** Përfaqësimi i barabartë që nga viti 2001 është përmirësuar ndjeshëm. Sidoqoftë, progresi i përfaqësimit të barabartë duhet të vazhdojë, aq më shumë që nga Komisioni Evropian numërohet si një nga kriteret për përmbushjen e standardeve të një sistemi të administratës publike të orientuar kah qytetarët.

***Programi per politika publike dhe administrate***

***Publikime te ardhshme:***

“Racionalizimi i vendeve te punes ne Administraten publike”

**Kontakt**

***Analitika***

Dame Gruev 7-8/3  
1000 Shkup, Maqedoni  
tel: + 389 2 312 1948  
web: [www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)  
[info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)

***Person pergjegjes per  
Programin per politika publike dhe administrate***

Agim Selami - hulumtues  
[aselami@analyticamk.org](mailto:aselami@analyticamk.org)

***Analitika*** - organizate e pavarur joprofitabile e perkushtuar per te ndihmuar persona dhe institucione ne perforcimin dhe permiresimin afatgjate te demokracise dhe udheheqjes si ne R. e Maqedonise ashtu edhe me gjere ne rajon.

***Analitika*** eshte organizate per analize dha hulumtim te politikave publike (think-tank), e perkushtuar ne promovimin dhe zhvillimin e bashkpunimit ndermjet subjekteve dhe organizatave ne R. e Maqedonise dhe me gjere.